



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Teknik Imazherie  
dhe Radioterapi”  
Universiteti “ALDENT”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Altina XHAFFERI** 


**Dr. Gjok TOSKU** 

**Shtator / 2021**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Bsc në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Teknik Imazherie dhe Radioterapi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 441, datë 25.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE / 11 PAK
18	Numri i studentëve:	119 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "ALDENT" (UA) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 539, date 13.06.2013 ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private "Aldent" në Universitet, me emërtimin Universiteti "Aldent". Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 305, datë 24.07.2013, riorganizohet institucioni në 2 Fakultete, në përputhje me Vendimin Nr. 442, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. IAL ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi të njësive kryesore si dhe te akreditimit institucional. Me Urdhër të MAS Nr. 115, datë 13.07.2017 hapet Njesia Kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me UMAS Nr. 111, datë 11.03.2016 Universiteti Aldent ka kaluar akreditim periodik institucional, në përputhje me Vendimin Nr. 124, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit. Së fundmi, Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022.

Struktura akademike e Universitetitv "ALDENT", aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
2. Fakulteti i Shkencave Dentare;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Programi i studimit Bachelor në "Teknik Imazherie dhe Radioterapi" është hapur me Urdhër të MASR Nr. 441. datë 25.07.2018 me formë studimi me kohë të plotë, 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi ofrohet nga Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që PS Bachelor në "Teknik Imazherie dhe Radioterapi" ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u ngjizur atyre aftësi për të konkretizuar njohuri teknike imazherike në përgjithësi, aftësi për të vetvepruar në kuadrin e organizimit e kryerjes së punëve zbatuese në ambjentet spitalore, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionalë, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën profesionale, aftësi në menaxhimin e problematikave të ndryshme, njohjen e standarteve dhe metodologjive bashkëkohore. Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij PS realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicje të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Master e Doktoratë. Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që PS Bachelor në "Teknik Imazherie dhe radioterapi" zhvillohet si një program i sukseshëm studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UA, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Altina Xhaferi, dhe Dr. Gjok Tosku. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Grupi u njoh dhe studjoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me axhendën e vizitës në institucion. Për shkak të situatës së pamdemisë Covid -19 u vendos që axhenda të ngushtohet në një ditë të vetme. Vizita u realizua me datën 15 Mars 2021. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Shefin e Departamentit të PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”. Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimin të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Universiteti Aldent është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.07.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 41/6 Prot, datë 23.07.2021. Universiteti Aldent përcjell në ASCAL më datë 30 Korrik, me anë të shkresës me Nr. 08/3 Prot, datë 28.07.2021, “Kthim përgjigje në lidhje me draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Teknik Imazheri dhe Radioterapi”**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Aldent synon arritjen e standardeve më të larta akademike, mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjekësisë. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që PS i ofruar nga IAL mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. <i>(Statusi i UA)</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar statutit, programi i studimit i ofruar nga UA synon përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UA. Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(statuti i UA)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UA ofron programe në disa prej fushave kryesore shëndetësore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre në vazhdim në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi Bsc në Teknik Imazheri dhe Radioterapi ofron një mundësi formimi për studentët në fushën e imazherisë dhe radioterapisë si pjesë e rëndësishme e kujdesit mjekësor. <i>(statuti i UA)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bsc në Teknik Imazheri dhe Radioterapi, synon në formimin e shprehive të profesionit duke i dhënë studentit autonominë e nevojshme në realizimin e detyrës dhe funksioneve të tij të përcaktuara nga profili profesional në drejtim të kujdesit shëndetësor në popullatë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi I.2**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2016-2020, në të cilën janë përcaktuar drejtimit strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UA, duke tentuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësidhënies të kërkimit shkencor me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë të shëndetit.</p> <p>Referuar RVB-së Universiteti “Aldent” ofron programe studimi që respektojnë gjithë kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe nuk bien ndesh me asnjë interes kombëtar. Studentët në UAL jo vetëm që marrin vlera të shtuara profesionale por edukohen me ndjenjën e humanitetit dhe vlerësimin e interesit kombëtar. Programi i studimit ofrohet në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë” si dhe gjetjeve të tij gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Programi i studimit Bachelor në “Teknik Imazhere dhe Radioterapi” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.</p> <p><i>(Strategjia e zhvillimit UAL 2016-2021)</i></p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>GVJ i konsultoi paraprakisht dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Universitetit "Aldent" dhe konstatoi sipas <i>(nenit 2 të statutit)</i> përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e Universitetit. Në mënyrë të veçantë programet e studimit të ciklit të parë hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin e Universitetit. Zbatimi i përcaktimeve statutores dhe rregullore të institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në zbatim të Urdhrit të MASR Nr. 441, datë 25.07.2018, është urdhëruar hapja e programit të studimit Bachelor në "Teknik Imazherie dhe Radioterapi", me një kohëzgjatje normale prej tre vitesh studimi akademike (180 ECTS). Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave, konstaton që PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, i cili ofrohet nga Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri si njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si njësi kryesore, është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit.</p> <p><i>(Rregullore UAT Rregullore fshmt)</i></p> <p><i>Referencë: DVV (Anekset 2, 4, 5, 7)</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="584 1805 762 1897">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="762 1805 975 1897">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="975 1805 1187 1897">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1187 1805 1457 1897">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


**Standardi I.3**

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në " Teknik Imazherie dhe Radioterapi " ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke nxitur pasionin për t'i thelluar njohuritë në ciklet e tjera të studimeve, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke njohur konkurrencën në tregun e punës dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabuset e lëndëve, kostatohet që ky program studimi ka për qëllim formimin e specialistëve me njohuri në fushën e teknikave imazherike dhe radioterapisë. Imazheristët e diplomuar në këtë program studimi, të jenë të aftë profesionalisht të ofrojnë me ndershmëri dhe seriozitet shërbim me nivel të lartë profesional në fushën e mjekësisë. Formimi i një figure profesionale fleksibël, e aftë për t'i ofruar me ndershmëri dhe profesionalizëm dijet dhe aftësitë e veta në shërbim të shëndetit të njerëzve.</p> <p><i>(Syllabuset. Objektivat e programit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës. Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Planifikimit të Karrierës, GVJ u njoh me aktivitetin konkret për ndjekjen e tregut të punës. Përveç komunikimit të formalizuar në dokumenta për interesin reciprok, në këtë zyrë disponoheshin edhe informacionet që merrnin studentët gjatë zhvillimit të praktikave në terren. Institucioni falë bashkëpunimit që ka me institucionet shëndetësore në vend, merr vazhdimisht informacione mbi nevojat dhe tregun e punës. Referuar statistikave të diplomuarve, emigrimit të tyre drejt tregut ndërkombëtar, rezulton se ende ka kërkesa për këtë drejtim profesionistësh. UAL vazhdimisht është në kontakt me ofruesit e shërbimit shëndetësor ku diskutohen kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve.</p> <p><i>(Evidencë Studim tregu Ba ne TIR.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënësve,</p>	<p>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin e programit të studimit kanë qëllim të pajisin studentët me:</p>


<p>garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njohuritë themelore të imazherisë dhe radioterapisë, etikës profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional;</li> <li>▪ Njohuri të avancuara në specialitete të vecanta të shërbimit imazherik dhe onkologjik si dhe ti përgatisë ata për mbrojtjen e shëndetit të pacienteve nga rrezatimet e ndryshme që përdoren në teknikat imazherike;</li> <li>▪ Aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacienteve dhe familjarëve. për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike;</li> </ul> <p>Realizimin e këtyre objektivave GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi duke analizuar kurikulën egzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentëve. Caktimin e një tutori studimesh, që i shoqëron studentët gjatë gjithë kohës së studimeve, GVJ e vlerëson si një gjetje me vlerë në përcelljen dhe realizimin me efikasitet të lartë të ndihmës për studentët.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR); (Syllabuse)</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 929 839 1025">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="839 929 1045 1025">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1045 929 1252 1025">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1252 929 1457 1025">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1025 839 1079"></td> <td data-bbox="839 1025 1045 1079"></td> <td data-bbox="1045 1025 1252 1079"></td> <td data-bbox="1252 1025 1457 1079" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi I.4</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UAL ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (hapur me VKM VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit ), çka tregon se tashmë se institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.</p> <p>Sipas evidencës (<i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.2</i>), ky Fakultet për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej <b>74 pedagogë</b>, nga të cilët <b>31 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 6 kanë gradën Dr., dhe 21 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>43 pedagogë</b></p>



	<p><b>me kontratë (PAK)</b> nga ku 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 11 kanë gradën Dr. dhe 29 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri ka <b>14 PAE</b> dhe <b>17 PAK</b>.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (<i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.7.3</i>), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie <b>28 pedagogë gjithsej</b>, ku <b>17 PAE</b>, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 4 me gradën Dr, 3 me SPA si edhe 9 asistente-lektore me Msc, dhe <b>11 PAK</b> nga të cilët 2 Prof.Asoc, 3 me gradën Dr, 2 me SPA si edhe 4 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 si numër fizik rezulton 60% me 40%. Edhe pse si numër fizik pedagogët efektiv janë në masën 60%, pedagogoet efektiv <b>PAE mbulojnë rreth 1379 ore ne auditor</b>, e cila perkon me rreth <b>70% te ngarkeses</b> totale mesimore. (<i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.11</i>)</p> <p>Për sa më sipër GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UAL është institucion jo publik në Republikën e Shqipërisë i orientuar tërësisht në ofrimin e programeve të studimit në fushën e mjekësisë. Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të UAL. Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. Institucioni zbaton me përpikmëri cdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar.</p> <p>(<i>Statuti i UAL</i>); (<i>Rregullore e Universitetit ALDENT</i>); (<i>Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore teknike</i>); (<i>Rregullore e programit te studimit TIR</i>);</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Laborant mjekësorë dhe imazheri, i cili ka kapacitetet akademike dhe logjistike për realizimin me sukses të programit mësimor. Fusha së cilës i përket Programi i Studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europiane. Departamenti i Laborant mjekësorë dhe imazheri përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi ofron dy programe të ciklit të parë.</p>

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti "ALDENT" ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe shërbimet mjekësore vendës e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrdhënieve Ndërkombëtare ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Konkretisht insitucioni kishte reagizuar një trajnim në Turqi për edukimin në vazhdim të stafit akademik dhe studentëve si dhe për krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese për degën e Imazherisë. Referuar dokumentit (Tabelat RVB Ba ne TIR. Tabela nr. 6) Universiteti Aldent ka nënshkruar një sërë marëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marëveshjet e bashkëpunimit në funksion të	Referuar RVB cdo vit akademik, institucioni dhe njësitë bazë kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. Pavarësisht vështirësive të hasura për shkak të pandemisë në këto dy vite akademike, UAL dhe partnerët janë përpjekur të harmonizojnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

realizimit të programeve të studimeve.	bashkëpunimin e tyre me situatën e re të krijuar. Marrëveshjet e realizuara me institucionet shëndetësore apo akademike kanë impact pozitiv. Vihet re rritje e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program vit pas viti.  (Tabelat RVB Ba ne TIR. Tabela nr. 19)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi që Universiteti Aldent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit përmes Koordinatorit të Studentëve. Akoma nuk ka përfunduar ciklin e parë të studimeve në degën e Teknik Imazherie dhe radioterapi, dhe eksperiencën është akoma e pa konkretizuar por vetë departamenti ishte aktiv në mbështetjen e marrëdhënieve me qendrat spitalore/punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe organizimeve të përbashkëta.  (Marrëveshjet e bashkëpunimit)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar RVB-së dhe vizitës në Institucion GVJ konstatoi se Universiteti Aldent është një institucion aktiv në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushat mjekësore. UAL ka ngritur marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në periudhën e pandemisë Covid 19 Departamenti referon vështirësi në organizimin e plotë të disa elementëve të praktikave profesionale në Institucionet shëndetësore. Institucioni referon për strategji të mëtejshme bashkëpunimi me institucionet shëndetësore. Aktualisht në këtë program studimi ende nuk janë diplomuar studentët por UAL ka eksperiencën e duhur dhe bashkëpunimet e nevojshme për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për studentët e diplomuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 24 lëndë me modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve shkollorë (8 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë; dhe 8 lëndë në vitin e tretë). Në 24 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihet edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 20, dhe lëndë me zgjedhje janë 4. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i> <i>(Rregullore e programit te studimit TIR)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi siguron formimin e shprehive të veçanta në fushën e teknikave Radiologjike. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i> <i>(Syllabuset Ba ne TIR.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të</p>	<p>Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi janë gjithëpërfshirëse duke filluar nga ato te formimit të përgjithshëm si shkencat e sakta,</p>



<p>kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>gjuhe te huaj apo anatomi dhe më pas duke u thelluar përgjatë viteve në lëndë më të detajuara si radioterapi, radiologji konvencionale dhe te avancuar, CT, MRI etj, të cilat synojnë të japin shprehje e nocione të avancuara të fushës.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i> <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.10)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Teknik imazherie dhe radioterapi” jep njohuritë themelore në lëndët e formimit bazë të cilat shërbejnë për formimin e përgjithshëm si profesional ashtu edhe akademik. Këto lëndë janë shpërndarë kryesisht në vitin e parë akademik. Më tej lëndët e tjera të formimit profesional shërbejnë për thellimin e kompetencave profesionale të studentit aktual por edhe të profesionistit të ardhshëm. Ne vlerësimin e syllabuseve të lëndëve profesionale vihen re zhvillim me kompetencë i temave të ndryshme të cilat do të shërbejnë në rritjen e aftësisë së profesionistit të ardhshëm për të zgjidhur probleme të ndryshme në fushën e dhënies së shërbimit të tij specifik.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve në Ba ne TIR)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Programi i studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” është një program studimi i ciklit të parë, ka një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është shqip. Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma "Bachelor" në Teknik Imazherie dhe Radioterapi.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kategoria A - 19%</li> <li>▪ kategoria B - 54%</li> <li>▪ kategoria C – 12.7%</li> <li>▪ kategoria D - 11</li> <li>▪ kategoria E – 3.3 %</li> </ul>

	Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Fakulteti ka në përbërje të tij 74 pedagogë gjithsej, ndërsa Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri ka 31 pedagogë ku 14 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 17 janë pedagogë me kontratë (PAK). Nga këto 3 pedagogë të Departamentit janë me titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 janë me gradën shkencore Doktor Shkencash, 4 pedagogë janë në process për fitimin e gradës shkencore Doktor shkencash.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Universiteti Aldent ka përfituar akreditimin si institucion me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr 114, datë 15.12.2017. Ky akreditim është i vlefshëm deri në datën 14.12.2022. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Deaprtamenti i Laborantit mjekësor dhe Imazheri përmbushin plotësisht të gjitha detyrimet ligjore që lindin nga ky proces në funksion të arsimit cilësor.</p> <p><i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.2)</i> <i>(Akreditimi institucional 2016)</i> <i>(Certifikatë akreditimi institucional 2017)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në Institucion dhe vlerësimi të dokumentacionit, u konfirmua se programi i studimit ka një kordinator i cili siguron mbarëvajtjen e programit mësimor. Koordinatori didaktik (përgjegjësi i programit) është paracaktuar të bëjë veprimtari që kërkojnë aftësi bashkëpunuese dhe komunikuese për të menaxhuar lidhjet midis subjekteve të brendshme dhe të jashtme të përfshirë në procesin mësimor. Koordinatori i programit merret me evidentimin e problemeve të studentëve në të gjitha vitet e studimit akademik,</p>

<p>Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>koordinon punën për krijimin e formateve të syllabuseve, oraret mësimore si dhe vë në dijeni stafin pedagogjik në lidhje me to. Gjithashtu reflekton shqetësimet e ngritura nga stafi akademik në lidhje me përmirësimin e syllabuseve apo planit studimor. Ai shërven si urë lidhëse mes përgjegjës të departamentit dhe stafit akademik si dhe studentëve.</p> <p><i>(Vendim dekanati për koordinatorët)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e UA që koordinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. UA ka 3 fakultete dhe secili prej tyre ka 2 njësi bazë (departamente) si dhe 1 Qendër promovimi apo kërkimore. Autoriteti udhëheqës është Dekani dhe më pas drejtuesit e departamenteve.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë;</li> <li>- Departamentin i laborantit Mjekësor dhe Imazheri;</li> <li>- Qendra e promovimit të shëndetit;</li> </ul> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti ka kombinim të stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Departamenti Laborantit Mjekësor dhe Imazheri i cili ofron programin Bachelor ne Imazheri dhe Radioterapi, plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucioent e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p><i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.1)</i></p> <p><i>(Statusi i UA)</i></p> <p><i>(Rregullore e UA, rregullore e FSHMT, rregullore e Departamentit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës ka angazhuar staf akademik duke respektuar specialitetin e lëndëve/ moduleve dhe me synim përcjelljen e informacionit akademik në përputhje me ekspertizën e lektorëve.</p> <p>Personelit akademik efektiv (PAE) mbulon rreth <b>72.6% të ngarkesës akademike në auditor.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FSHMT në akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij <b>74 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, 31 janë staf akademik efektiv ( PAE), dhe 43 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021:</p> <p><b><u>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;</li> <li>- 16 PAK, ndër të cilët, 8 me tituj / grada;</li> </ul>

**Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri:**

- 14 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;
- 17 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;

**Qendra e Promovimit të Shëndetit:**

- 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada;
- 10 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;

Ndërsa Departamenti Laborant Mjekësorë dhe Imazheri që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:

Për vitin akademik 2018-2019, (7 PAE / 11 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 6;

Për vitin akademik 2019-2020, (8 PAE/ 16 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 10;

Për vitin akademik 2020-2021, (14 PAE / 17 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 9;

*Departamenti nuk ka asnje pedagog efektiv me titullin Profesor. Ka 2 pedagogë me titullin Profesor i Asociuar. Ka 2 pedagog me gradën shkencore Doktor Shkencash si dhe 3SPA.*

Personeli akademik i programit të studimit në vitin akademik 2020-2021 përbëhet nga personel akademik me grada dhe tituj nga MSC deri ne Prof Asoc. Një kontribut të rëndësishëm në realizimin e programit të studimit jep personeli ndihmës akademik (2 individë të angazhuar) të cilët angazhohen në realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale.

*GVJ i rekomandon Institucionit qe ne mbeshtetje te ligjit të arsimit të lartë sipas së cilës personeli akademik efektiv duhet të ketë të paktën gradën Shkencore “Doktor Shkencash”, të marrë në konsiderat punësimin e stafit akademik me gradën shkencore të paktën “Doktor Shkencash”.*

*(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.2)*



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi II.3**



**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri dhe FSHMT zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p><i>(Plani mësimor, rregullorja e programit; syllabusët e lëndëve; CV e personelit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar planit mësimor të PS, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Programi i studimit “Teknik imazherie dhe radioterapi” është organizuar në tre vite akademike me 6 semestra.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 24 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollorë (8 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë; 8 lëndë në vitin e tretë). Në 24 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 20. Lëndë me zgjedhje janë 4. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 34 ECTS (19%)</li> <li>- Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 97 ECTS (54%)</li> <li>- Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 23 ECTS (12.7%)</li> <li>- Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 20 ECTS (11 %)</li> <li>- Kategoria E (detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%)</li> </ul> <p>Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p>

	<p><i>GVJ rekomandon, që për rëndësinë e modulit të Mamografisë kjo duhet të zhvendoset nga Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje) në kategorinë B (lëndë të formimit karakterizues) pasi është modul që duke ditur karakteristikat e profesionit Mamografia duhet të mos konsiderohet lëndë me zgjedhje.</i></p> <p><i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie dhe Radioterapi)</i>  <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.10)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj.</p> <p>Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë:</p> <p>10 pikë -Aktivizimi (Aktivizimi në orët mësimore, detyrat e kursit, etj.)</p> <p>20 pikë – Labororet;</p> <p>10 pikë – Kolokiumi;</p> <p>60 pikë -- Provimi Përfundimtar;</p> <p><i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie dhe Radioterapi)</i>  <i>(Syllabuset e lendeve)</i>  <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.12)</i>  <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.13)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e Srtudimit Bachelor në Imazheri dhe Radioterapi duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. UAL ofron mundësi për transferime në hyrje dhe në dalje të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të pare. Me urdhër të dekanit ngrihet Komisioni i Ekuivalentimit të programeve. Në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve të rinj UA rekruton kandidatët që kanë zgjedhur preferencën e tyre për degën e studimit nëpërmjet u-albania bazuar nga kërkesa e departmentit për numrin e studentëve qe mund të rekrutohen në Departamentin e Laborantit Mjekesor dhe Imazheri. Në llogaritjen e pikëve përqindja e notës mesatare të shkollës do të zërë 60% të pikëve ndërsa përqindja</p>


	<p>e notës mesatare nga provimet e maturës shtetërore do të jetë në masën 40%.</p> <p><i>(Vendim senati per kriteret e pranimit të studentëve)</i></p> <p><i>(Procedura e transferimi të studenteve UA)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënimit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p><i>(Syllabuset e lendeve)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Refruar RVB dhe Takimeve ne institucion dokumentacioni i programit mësimor është në përditësim të vazhdueshëm dhe në cdo fillim viti akademik dorëzohet sipas formateve të aprovuara dhe të miratura në Senatin akademik dhe arkivohet në department. Programi i studimit ka pasur ndryshime të pakta përgjatë këtyre viteve pasi edhe nuk është mbyllur akoma një cikël i plotë studimi. Megjithë përpjekjet e stafit akademik për përmirësimin e syllabuseve vit pas viti kërkohet punë me kompetencë edhe për përmirësimin e programit studimor. <i>(Programi i studimit)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

#### Standardi II.4



**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënimit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 1 kredit leksion është e konvertuar me 10 orë leksion në auditor dhe 1 kredit seminar është e konvertuar në 8 orë mësimore në auditor, 1 kredit praktikë është e konvertuar në 25 orë</p>

	<p>mësimore apo praktike. 1 kredit ka në total 25 ore (në auditor +individuale).</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i></p> <p><i>(Syllabuset e lendeve)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimet e moduleve\lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale mundësojnë njohuri, aftësim për punë të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndë bazë të formimit të përgjithshëm ndërsa në dy vitet e tjera akademike programi i studimit parashikon zhvillimin e lëndëve me formim specifik profesional duke ndihmuar kështu në rritjen e kompetencave të studentëve. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfitimit të njohurive bazë studenti zhvillon në mënyrë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga Radiologjia konvencionale dhe duke vazhduar drejt lëndëve të cilat merren me radiologjinë e avancuar si CT, MRI, Mjeksësi nukleare. Po ashtu studenti merr njohuri te plota edhe për Lëndën e radioterapisë si element i rëndësishëm i ofrimit të kujdesit shëndetësor. Të gjitha këto njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e radiologjisë në cdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i></p> <p><i>(Syllabuset e lendeve )</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>(Programi i studimit BA në teknik imazherie dhe Radioterapi )</i></p> <p><i>(Syllabuset e lendeve )</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i</p>



<p>punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme imazherike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një institucion shëndetësor. Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me intitucione që ofrojnë shërbime imazherike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p><i>(Programi i studimit BA në teknik imazherie dhe Radioterapi)</i>  <i>(Marreveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura në gjuhën shqipe e këtij programi ka problemet e veta në mungesën e teksteve në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaja.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve )</i>  <i>(Lista e literaturës në bibliotekë )</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Imazheri dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>(Programi i studimit bachelor)</i>  <i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse</p>	<p>Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me</p>

konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar dokumentit ( <i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabelat nr.7, 7.2 dhe 7.3</i> ) të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:  Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë të angazhuar <b>13</b> pedagogë ndër të cilët <b>7 PAE</b> dhe <b>6 PAK</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Mbulimi i programit në përqindje është <b>54% PAE dhe 46% PAK</b> . Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>16</b> pedagogë ndër të cilët <b>5 PAE</b> dhe <b>11 PAK</b> . Mbulimi i programit në përqindje është <b>32% PAE dhe 68% PAK</b> . Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>28</b> pedagogë ndër të cilët <b>17 PAE</b> dhe <b>11 PAK</b> . Mbulimi i programit në përqindje është <b>61% PAE dhe 39% PAK</b> . Referuar dokumentit ( <i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabelat nr.11 dhe 12</i> ) PS ne vitin akademik 2020-2021 ka <b>1955 ore mesimore nga te cilat 524 ore mbulohen nga PAK pra rreth 27% dhe stafi akademik PAE mbulon 1431 ore mesimore pra 73%, duke plotësuar kështu kriterin per ngarkesen mesimore mbi 70%</b> .  Për sa i përket kualifikimeve të Personelit akademik: <ul style="list-style-type: none"><li>- Për 2018-2019, 46% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 54% janë Msc;</li><li>- Për 2019-2020, 56% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 44% janë Msc;</li><li>- Për 2020 -2021, 54% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 46% janë Msc.</li></ul> Personeli akademik i angazhuar ne mësimdhënie zotëron kualifikimin e duhur akademik për mësimdhënie dhe për kryerje të veprimtarive të

	<p>tjera mësimore në lëndët e këtij programi. Ne kete program vihet re angazhimi i vetem nje asistenti i cili eshte diplomuar si Teknik Imazherie. Duke ditur specifikat e programit te studimit GVJ konstatoi se pervec angazhimit te personelit teknik imazherie ne procesin e praktikave profesionale spitalore do ishte e keshillueshme angazhimi si ndihmes akademik I personave te diplomuar ne degen Teknik imazherie si element komplementar ne mesimdhënien teorike te studenteve te ketij programi studimi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” pothuaj zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.</p> <p><i>GVJ rekomandon te plotësohet stafi akademik me të paktën gradën shkencore “Doktor”, dhe stafi ndihmes akademik me te diplomuar ne teknik imazherie me graden MSC.</i></p> <p><i>(CV e personelit akademik)</i></p> <p><i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.7, 7.2, 7.3 dhe 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të Imazherise si radiologji, radioterapi, fizikantë mjekësor dhe teknik radiologë. Lëndët mbikqyren nga një grup pedagogësh me tituj akademik.</p> <p><i>GVJ i sugjeroi Departamentit të vlerësojnë mundësinë e punësimit të asistentëve lektorë të diplomuar si Teknik Imazherie.</i></p> <p><i>(CV e personelit akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve ne Institucion, Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si objekt shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, organizmin e aktiviteteve të përbashkëta akademiko-shkencore si dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. Stafi i mjekëve imazherist dhe teknikëve pranë institucioneve të bashkëpunimit angazhohet në mbikqyrjen dhe zhvillimin me sukses të praktikave klinike. Për garantimin e funksionimit të infrastrukturës laboratorike, institucioni angazhon</p>

<p>diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>personel ndihmës mësimor e specialistë të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet. Në të gjitha rastet kur praktika zhvillohet jashtë UAL, angazhohet përgjegjësi i programit për organizimin dhe stafi i institucioneve për për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p><i>(Marreveshjet e bashkepunimit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent zhvillon mësimin ne disa lëndë specifike kryesisht ato te formimit te pergjithshem, duke shfrytëzuar ambjentet e kabineteve qe institucioni disponon si auditorin e anatomise, te IT, etj. Stafi ndihmes mesimor eshte i angazhuar plotesisht në ndihmë te realizimit te oreve laoratorike por edhe per mirembajtje e kabienteve apo mjediseve mesimore.</p> <p>Për shkak të karakteristikave të këtij programi studimi laboratorët për formimin karakterizues të studentëve gjenden vetëm pranë insittucioneve shëndetësore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Referuar RVB-së, Universiteti për shkak të specifikës së situatës së pandemisë covid 19 ku është zhvilluar pjesa më e madhe e studimit në këtë program, ka adaptuar përdorimin e metodologjisë online të mësimdhënies. Megjithatë universiteti ka ndërtuar një strategji zhvillimi për përmirësimin e mësimdhënies dhe me element të caktuar të tij po punon dhe aktualisht. Gjithashtu UA ka hartuar dhe materialin udhëzues për metodat e mësimdhënies në distance (online). Këto udhëzues janë publikuar në faqen zyrtare të uniuersitetit.</p> <p><i>(Rregullore UAL- LMS),</i> <i>(Rregullore e provimeve online)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të mësimdhënies. Indikatorët e përdorur nga kjo njësi reflektohen në formularin e performancës së pedagogut. Kjo njësi përgatit raportin përfundimtar me evidentimin e problematikave eventuale dhe synon të evidentojë praktika efektive në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>(Rregullore e NjSBC)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në fund të semestrit dhe në mënyrë periodike i kërkohet studentëve të plotësojnë një pyetsor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndëve. Paraqiten pyetje të shumta me qëllim vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Nga ana tjetër studentët janë vazhdimisht në kontakt me koordinatorin e programit për paraqitjen e problematikave të tyre. Rezultatet e pyetësorit janë analizuar dhe vlerësuar me qëllim përmirësimin e indikatorëve dhe treguesëve të institucionit. Në fund bëhet raporti përfundimtar.</p> <p><i>(Rregullore e NjSBC)</i> <i>(Pyetsori i studenteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>Referuar formatit të pyetësorit, pyetsori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga elementët e rëndësishëm që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Pyetësori i studentëve i zhvilluar në vitin akademik 2020 – 2021, përmban një analizë të detajuar me gjetjet dhe konstatimet. NJSBC si struktura përgjegjëse analizon gjetjet dhe ia përcjell Senatit Akademik Pastaj NJSBC</p>

	harton planin e aktiviteteve në përmbushje të kërkesave të sudentëve. <i>(Rregullore e NjSBC),</i> <i>(Pyetsori i studenteve)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Rezultatet e përftuara nga pyetsori si dhe nga vlerësimi i performacës reflektohen në dosjen individuale të personelit akademik. Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira si dhe inkurajon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura etj. Institucioni ka nenshkruar marrëveshje bashkepunimi me universitetet nderkombëtare dhe inkurajon mobilitetin e stafit në bazë të Projeksit Erasmus+.  <i>(Pyetsori i studenteve)</i> <i>(Formulari i performances akademike)</i> <i>(Marreveshjet e bashkepunimit)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ duke iu referuar përmbajtjes së syllabuseve, planit mësimor si dhe rregullores së institucionit në përputhje dhe me specifikën e programit të studimit konstaton se format e mësimdhënies përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Departamenti organizon trajnime apo ëorkshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Në kuadër të mësimin online institucioni ka realizuar webinarë apo leksione të hapura online. Ndihmë në këtë drejtim jep Platforma e edukimit në distancë UAL – e-learning ( <a href="https://ual.iqe.al/">https://ual.iqe.al/</a> ) e cila krijon gjithashtu mundësi për prezantimin e veprimtarive laboratorike që zhvillohen në institucion. Kjo metodë ndihmon studentët të ndjekin në kohë reale dhe të jenë interaktive gjatë zhvillimit të saj.  <i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i> <i>(Syllabuset)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe	

<p>t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me stafin e programit, por edhe me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni nëpërmjet trajnimeve, por edhe pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, synon të nxisë personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. <i>(Strategjia e zhvillimit të UAL)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke iu referuar CV të stafit akademik, por edhe informacionit të siguruar gjatë takimeve me stafin akademik dhe me studentët e programit, rezulton se stafi është kompetent për njohuritë dhe konceptet që shpjegon. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Laborantit Mjekësor dhe Imazheri përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe profilin e lëndëve. Zhvillimi i veprimtarive nëpërmjet platformës së edukimit në distancë ka qënë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Këtu vlen të përmendet dhe puna e NJBSC në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies si dh roli i koordinatorit të programit, i cili reflekton ankesat e arsyetuara të studentëve në biseda konstruktive me pedagogët për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të</p>

diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarët. Studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. <i>(Plani mësimor, syllabuset)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <i>(Plani mësimor, syllabuset)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, konstaton se procesi mësimor i programit të studimit, realizohet në hapësira të mjaftueshme, cilësore, higjienike dhe që mirëmbahen rregullisht. Institucioni ka kampusin e tij të ri dhe ka pasur ambientet më moderne që nga fillimi i tij. <i>(Planimetri Kampusi i ri)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të pajisura me pajisjet më moderne, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën moderne etj.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme	UAL ka pajisur kampusin e vet me teknologji të avancuar të informacionit. Në të gjithë universitetin është i mundur aksesin në rrjetin kompjuterik të shkollës, sistemet e menaxhimit, dhe sekretarisë mësimore. Universiteti i pajis studentët dhe stafin e tij me emaile me baze Google. Po ashtu studentët kanë akses të palimituar në platformën e mësimi online LMS. Pëveç menaxhimit të mësimdhënies, platforma

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

<p>për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>e LMS shërben edhe për marrjen e shënimeve, njoftimeve të ndryshme. Studenti mund të përdori këtë platform për dorëzimin e projekteve apo detyrave të kursit. Shërbimi databazës së centralizuar është shtrirë edhe në shërbimin e sekretarisë mësimore që menaxhon në mënyrë të centralizuar databazën e studentëve, regjistrimet, provimet, notat e studentëve dhe cdo dokumentacion tjetër që lidhet me studentët. Edhe këtë sistem studentët mund ta aksesojnë online nëpërmjet internetit. Lidhur me infrastruktuën e brendshme, institucioni disponon salla leksionesh seminaresh, të pajisura me kompjutera dhe projektorë, gjithashtu u jepet dhe akses ne internet nëse është e nevojshme.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit ALDENT. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti Aldent gjithashtu ka akses në një numër bibliotekash on-line. <i>(Lista e librave/periodikëve shkencorë në bibliotekë)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB-së, UAL ka vënë në dispozicion të bibliotekës një hapësirë të konsiderueshme dhe modern ku janë afishuar rreth 16 mije botime, universitare, periodikësh, studimesh etj. Biblioteka funksionon me sistem elektronik dhe aksesohet si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës gjendet kryesisht në gjuhën angleze. Biblioteka zoteron shumë pak tituj shqip në lidhje me programin e studimit Bachelor ne Teknik Imazherie dhe radioterapi. <i>(Lista e librave/periodikëve shkencorë në bibliotekë)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Paralelisht me bibliotekën fizike, UAL është i abonuar prej disa vitesh në bibliotekën "Hinari", bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët. <i>(Biblioteka dhe menaxhim)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe shumë të pajisur. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Laboratorët mbulojnë një pjesë të formimit të studentëve. Për shak të specifikës së programit të studimit</p>

	pjesa më e madhe e praktikave profesionale zhvillohet jashtë territorit të kampusit.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Referuar RVB-së, dhe taskimeve në insitucion u konstatua se UAL-LMS është sistemi kryesor i komunikimit dhe ndërveprimit në institucion i cili aksesohet nëpërmjet internetit. I gjithë stafi dhe studentët zhvillojnë të gjitha veprimtaritë nëpërmjet këtij sistemi qoftë proceset mësimore po veprimtaritë e tjera administrative e kërkimore. Kjo platformë përdoret edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, prezantime, diskutime etj. Në sistemin LMS çdo student ka akses dhe merr materialet mësimore të lëndëve të ndryshme, apo depoziton detyrat lëndore.  <i>(Rregullore e veprimtarive online)</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Studentët dhe pedagogët përdorin sistemin e brendshëm të komunikimit nëpërmjet përdorimit të adresave elektronike të fakultetit, google drive. Por sistemi më i rëndësishëm i komunikimit është ai i mësimdhënies së ofruar nga Universiteti LMS. Ky system ka rezultuar një sistem i mirë komunikimi si dhe mesimdhënies.  <i>(Rregullore e veprimtarive online)</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Programi i studimit nuk përfshin mbrojtje diplome me përgatitjen e nje teme te vecante nga cdo student por dhenien e nje provimi perfundimtar i cili është një test përmbledhës i njohurive që student ka marrë gjatë të tre viteve akademike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4



**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë	Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, UA ka krijuar Njësinë e Brendëshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi ka funksionin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë. Po ashtu kjo njësi luan rolin edhe në monitorimin dhe përmirësimin e programve mësimore, në vlerësimin e performancës së stafit akademik, vjen në ndihmë edhe të studentëve. Kjo njësi është përgjegjëse edhe për


Adresa: "Ruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>hartimin e raporteve vjetore ku paqyrohen problematikat e dala gjatë vitit akademik si dhe rekomandimet për kapërcimin e tyre. <i>(Rregullore e NJBSC)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së funksionimit të programit të studimit, vërehet që Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri është struktura bazë e cila në bashkëpunim edhe me strukturën e koordinatorit të programit është përgjegjës për mbështetjen e eksperimentimin apo zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Metodot kryesore përfshijnë përfitim të njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale apo në grup, leksione të hapura, praktika laboratorike <i>(Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale vullnetare (p.sh. vlerësimi i dëmeve pas tërmetit), seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor. <i>(CV e stafit akademik)</i> <i>(vizita në Institucion)</i> <i>(Mobilitete të stafit dhe studenteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri si dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizojnë në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimit të mbajtura nga trajnues ndërkombëtarë, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit. <i>(Mobilitete të stafit dhe studenteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit si dhe në Planin Strategjik të Departamentit, stafi akademik i programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi dhe stafi mbështetës janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. <i>(Mobilitete të stafit dhe studenteve)</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion u prezantuan aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës akademik trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. <i>(Mobilitete te stafit dhe studenteve)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbyshet</b></p>	<p><b>Përmbyshet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbyshet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbyshet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

### Standardi III.5


**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni sanksion mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale në rregullore.</p> <p>Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara eshë në faqen e Internetit të Universitetit. Regullorja e insitucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. UAL ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien online dhe testimin e njohurive. Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës online siguron informimin e plotë të studentëve.</p> <p><i>(Syllabyset e lendes)</i>  <i>(programi i studimit)</i>  <i>(Mësimi online)</i>  <i>(Rregullore provimesh on line),</i>  <i>(Udhëzues për provimet online)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik, në javën e parë të semestrit, informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënit të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj. Syllabuset e lendeve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al







lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<i>(Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke iu referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton, se njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes shumatoreve të formave kryesore të vlerësimit si: provim i ndërmjetëm, prezantim, laborator, provim përfundimtar, pjesëmarrje aktive.  <i>(Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Ng shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit, realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare. Provimet e ndërmjetme apo vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi sipas syllabusit përkatës por në përgjithësi 30% të vlerësimin përfundimtar studenti e grumbullon nga vlerësimi i vazhdueshëm dhe 70% nga provimi përfundimtar. Programi i studimit ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në aftësitë profesionale.  <i>(Rregullore e studimit)</i> <i>(Programi i studimit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online. UA ka hartuar edhe platformën e provimeve online, rregullore që i është bërë e qartë edhe studentëve që në fillim të vitit akademik. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit.  <i>(Rregullore fakultetit)</i>

	<i>(rregullore programi studimi)</i> <i>(programi i studimit)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar rregullores së programit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mesimor. <i>(Rregullore programi studimi)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Gjatë realizimit të provimit studenti pajiset me barkodin individual nga sekretaria mësimore. Vlerësimi i studentëve është anonim. Studenti gjatë provimit online monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik apo ndihmës akademik si dhe nga sekretaria mësimore. Në fund të provimit student përfiton pikët përkatëse të grumbulluara të cilat më pas konvertohet në notë. <i>(Rregullore e provimit online)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit, i cili ka të drejtë ti dijë ato. Në fund të ballafaqimit me studentët pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të studnetit. <i>(Rregullore programit te studimit)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Universiteti, nëpërmejt rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. <i>(Rregullore fakultetit)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e përfundimit të vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura edhe në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar. <i>(Rregullore e sekretarise)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentëve u ofrohet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti ngre një komision të posacem i cili rivlerëson tezën në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky process dokumentohet në department. <i>(Rregullore fakultetit)</i>

<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Nuk referohen raste ankimi nga ana e studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve përfundimtare dhe nuk ka pasur asnjë ankimin drejtuar Përgjegjësit të departamentit. (RVB)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në PS, GVJ është e mendimit se përbërja e planit mësimor si dhe zhvillimi i lëndëve garantojnë mundësinë për thellimin e njohurive, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. (Plani mesimor Ba ne TIR)
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar planit mësimor 11% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit, dhe ndërveprimit si Informatikë mjekësore, Psikologji, Anglishte profesionale, etj. <i>(plani mësimor)</i> <i>(Programet)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në përfundim të çdo lënde përmbledhen analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti sipas syllabuseve të çdo lënde. Bazuar në këto informacione të mbledhura, pedagogu i lëndës rishikon çdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e zhvillimit të mësimin, sygjeron ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton	Zhvillimi i procesit mësimor bëhet duke kombinuar mësimdhënien tradicionale dhe paraqitjen apo përcimin e informacionit online. Mësimi ka interaktivitet dhe komunikim të rrjedhshëm me studentin gjë e cila shërben dhe për ngritjen e problemeve të ndryshme si dhe

studentët për implementimin e tyre.	orientimin e studentëve për zgjidhjen dhe implementimin e tyre në sferën praktike.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se stafi akademik i programit, ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Stafi akademik mbështetet nga Departamenti dhe Universiteti për realizimin e aktiviteteve të ndryshme si leksione të hapura, konferenca, workshope etj.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët mjekësore, si dhe në praktikat profesionale. <i>(Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Mbështetur në informacionin e siguruar gjatë takimeve me stafin akademik, studentët, por edhe syllabuseve, stafi akademik inkurajon, nxit dhe mbështet punën në grup të studentëve, për rastet studimore dhe për projektet e kursit. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi. <i>(Kurrikula e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndër-kombëtare.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera. Studentët e FSHMT prej vitesh marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit. <i>(Rregullore e senatit studentor)</i> <i>(Rregullore e tutoriatit)</i>
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Eksperiencia e mëparshme në mobilitetin e stafit akademik si dhe studentëve ka angazhuar Universitetin në realizimin e marrëveshjeve të vazhdueshme bashkëpunimi. Universiteti ka pasur vëshitrësi aktuale të Pandemisë virale botërore në implementimin e plotë të tyre por procedurat janë shtyrë për një periudhë më të përshtatshme. Megjithatë zyra e projekteve dhe marrëdhënie ka rol të



	rëndësishëm për ndihmën ndaj studentëve. ( <i>Mobilitetete stafit dhe studentëve, Bursat për Erasmus+</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar në DVV si dhe nga informacioni i siguruar nga takimi me studentët, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, ose mbrojtjen e diplomës, e sanksionuar në rregulloren e institucionit. Institucioni e bën atë publike në faqen e internetit nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.  ( <i>Rregullore e Universitetit ALDENT</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Informacioni dhe udhëzimet për provimin final janë vënë në dispozicion të studentëve dhe është e publikuar dhe në faqen online. Pedagogët përgjegjës përgatisin një program mbështetës për provimin përfundimtar. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar.  ( <i>Syllabuset e lendeve</i> ) ( <i>Programi i studimit</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre bachelor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.  ( <i>Vendim dekani për komisionin e provimeve të diplomimit</i> )
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Nga vizita në universitet dhe shqyrtimi i syllabusit përkatës mësohet që stafi akademik përgjegjës për provimin e përgjithshëm përfundimtar është këshillues i studentëve të vitit të tretë.

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët në përgatitjen për provimin përfundimtar.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për provimin e diplomimit dhe e shpërndajnë atë tek studentët në fillim të semestrit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato në përgatitjen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>(Rregullore e provimit online)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimin të diplomës.</p> <p><i>(Rregullore e fakultetit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë dhe kompletimin e 180 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomën përkatëse si dhe me Suplementin e Diplomës.</p> <p><i>(Rregullore e fakultetit)</i> <i>(Formati i suplementit TIR)</i> <i>(Formati i suplementit TIR)</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Dokumenti i diplomës do të shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës të firmosur nga organet drejtuese të Fakultetit dhe nënshkruar nga Rektori.</p> <p><i>(Formati i suplementit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Referuar RVB-së, UAL arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe rast pas rasti bazuar në kërkesat e studentit lëshohen vërtetime me qëllime të ndryshme.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nat. përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Referuar rregullores se institucionit dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton se në Universitetin Aldent, mbledhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë e të pjesshme si dhe ato të personelit ndihmës.</p> <p>Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhet në dosje e personelit/. Ne dosjet që u shqyrtuan nga GVJ gjatë takimit në Zyrën e burimeve njerëzore u konstatuan se ne to gjendeshin të gjitha të dhënat e kerkuara dhe ato ishin të përditësuara.</p> <p>Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerësore GVJ u interesua të njihej me zbatimin e proceduarave të rekrutimit të personelit dhe gjeti që ato ishin kryer konform akteve ligjore e nenligjore</p> <p><i>(Rregullore e Universitetit ALDENT)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni disponon një procedurë për punësimin e personelit akademik. Departamenti parashtron vendet e lira në përputhje edhe me planin mësimor. Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel akademik, nevoja këto që i parashtrihen Zyrës së Burimeve njerëzore. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit ndiqej me rigorozitet e transparence. Nevoja për personel akademik bëhet publike duke specifikuar specialitetin e duhur dhe kriteret që duhet të plotësojë cdo kandidat. Dosjet e kandidateve shqyrtoheshin nga komisioni i rekrutimit. Pasi komisioni i rekrutimit te stafit bënte</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	vlerësimin e personelit akademik, ZBNJ angazhohej në hartimin e kontratës mes palëve. (Procedura e rekrutimit të stafit)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura për rekrutimin e stafit përmban të gjitha hallkat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësues dhe administrativ. ZBNJ drejton të gjithë procesin. ZBNJ e fillon procesin pasi merr kërkesën nga Njësia bazë. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Pasi bëhet shpallja dhe merren në dorëzim dosjet e aplikantëve, ngrihet komisioni përkatës me 5 persona ku të paktën 3 janë anëtarë të departamentit i cili shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë. Kandidatet klasifikohen sipas pikëve të fituara dhe merret vendimi përkatës. GVJ gjykon që proceduara e rekrutimit të stafit garanton rekrutimin e personelit në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e PS.  (Procedura e rekrutimit të stafit)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në rregulloren e institucionit dhe nga vizita në institucion, me konkretisht turi i ambienteve, GVJ konstaton se institucioni është angazhuar dhe disponon mjediset si dhe mundësitë e përshtatshme për kryerjen e aktivitetit akademik dhe shkencor të personelit. Institucioni ve në dispozicion të stafit të gjithë infrastrukturën laboratorike dhe pajisjet e kohës në fushën e shëndetësisë. Bazuar në RVB dhe takimin me stafin rezultoi se ambientet e Institucionit ishin të përshtatshme dhe funksionale për kryerjen e detyrave mësimore, kërkimore e shkencore.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Referuar dhe RVB, GVJ konstatoi se Universiteti Aldent organizon vazhdimisht trajnime për stafin akademik me qëllim aftësimin profesional të stafit. Po ashtu stafi akademik ishte inkurajuar të merrte pjesë në projektet e shkëmbimit si: CEPUS dhe ERASMUS+. Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton gjithashtu se stafit akademik u krijohen mundësitë dhe kushtet e nevojshme për të marrë pjesë edhe në trajnime profesionale jashtë institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të	Referuar (Tabelat RVB Ba në TIR, tabelat nr.17), GVJ konstaton se institucioni organizon trajnime pedagogjike lidhen me metodologjitë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	më efektive të mësimdhënies. Bazuar në takimin me stafin akademik dhe platformës UAL-LMS rezulton se UAL në kuadër të procesit mësimor zbaton metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive, përdor module specifike për të mbështetur metodat inovative të mësimdhënies si krijimi i klasave virtuale, shkëmbimi i materialeve me studentët, ndërveprimi dhe komunikimi me studentët, përditësimi i ndërfaqes personale të pedagogut. Gjithashtu UAL, përfshin staf akademik të huaj, kryesisht në programin e ciklit të tretë, si dhe ndihmon personelin vendas të UAL të rrisë performancën e vet, nivelin e bashkëpunimit dhe kërkimit shkencor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB dhe evidencën nr. 15 si dhe vizitën në institucion, rezulton se UAL vë në dispozicion ambjente të bollshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënës duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditorët, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. Gjithashtu UAL ka në dispozicion dhe kampusin e ri të sapo ndërtuar ambjente të dedikuara për një proces akademik me standarte të larta logjistike, me hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, praktike e laboratorike.  (RVB)  (Vizita në institucion, turi i ambjenteve)
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GVJ gjeti paisje të tilla si: tabelat interaktive, projektuesit video, kompjuterat dhe internetin të cilat ishin funksionale. Po ashtu laboratori i anatomisë ishte i pajisur me të gjitha pajisjet dhe instrumentët që nevojiteshin për të realizuar mesimin, Edhe laboratorët e lendëve plotësuese si informatikës apo gjuhëve të huaja ishin të pajisur me të

teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	gjitha pajisjet dhe softet për zhvillimin e procesit mësimor konform programit.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të studimit në tërësi.	Laboratorët sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të studimit në tërësi.  Rëndësi i është kushtuar vizualizimit të procedurave të ekzaminimit nëpërmjet softuerëve demonstrues me anën e të cilëve studentët praktikohen në modalitetet e marrjes së imazheve dhe kryerjes së ekzaminimeve të ndryshme. Laboratori i imazherisë dixhitale është fokusuar tërësisht në zbatimin e metodave inovative në imazherinë mejkësore. Në mjediset e fakultetit aksesohet interneti nëpërmjet Wi-Fi ndërsa laboratorit i informatikës u vihet në dispozicion studentëve edhe për veprimtari të tjera.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	(RVB) (Vizita në institucion, turi i ambjenteve) (Takimi me studentët)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar RVB si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se për programin mësimor Bachelor në Imazheri dhe Radioterapi mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe njëkohësisht të posaçme si për zhvillimin e leksioneve e seminareve por edhe të shumë prej laboratorëve të Programit të studimit. Për vetë specifikat e programit të studimit praktikat profesionale duhet të realizohen domosdoshmërisht jashtë ambjenteve të Institucioni dhe përkatësisht në spitale apo klinika të ndryshme shëndetësore, dhe për këtë Institucioni kishte siguruar marrëveshje bashkëpunimi.  (Marrëveshjet, Marrëveshjet me spitalet dhe klinikat imazherike)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e	Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve ishin dy biblioteka mësimore me dy salla leximi të pajisura me vende leximi dhe internet. Referuar RVB-së, biblioteka

shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	përmban rreth 13 mijë e pesëqind tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Në bibliotekën e FSHMT ka rreth 5 mijë libra në dispozicion.			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nuk ka të dhëna mbi efikasitetin e përdorimit të bibliotekës, ndërkohë që literatura bazë–dispencat menaxhohen nga sekretaria mësimore. UAL ka disa vjet që ve në dispozicion edhe bibliotekën on-line “Hinari” bibliotekë e OBSH. Kompjuterat e instaluar në ambjentet e bibliotekës ofrojnë akses pa kufizim interneti. Për materialet e bibliotekës ekziston edhe katalogu elektronik. GVJ vlerëson që biblioteka ka tekste mësimore vetëm në gjuhë të huaj si dhe ka revista apo libra shkencorë të cilat rezultuan tekste dhe informacione bashkëkohore. U vu re prania e një numri të vogël të titujve në gjuhën shqipe të lidhura me kete program studimi. Realisht ka pak tituj shqip në lidhje me kete program studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Ambjentet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Institucioni i ka krijuar kushte të përshtatshme cdo studenti për aksesimin e bibliotekës si atë fizike ashtu edhe asaj online. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Ne kushtet aktuale të zhvillimit të mesimit në kuader të pandemisë Covid 19 , studentet kishin akses vetëm në bibliotekën online e cila ka tekste në gjuhë të huaj. <i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të PS.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	(Biblioteka) (Takimi me stafin akademik)			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Pak përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstaton që Universiteti Aldent disponon sistem të menaxhimit të informacionit me të cilin administrojnë gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim.  Cdo anëtar i stafit dhe cdo student ka adresën e vet të e-mailit, të cilën mund ta aksesojë në cdo kohë brenda dhe jashtë universitetit. Nëpërmjet platformës së edukimit në distancë UAL-LMS, studentët aksesojnë të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstaton se sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.  Të dhënat e sekretarisë mësimore, stafi akademik dhe studentët koordinohen me anë të platformës Fx Education e cila siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ky sistem integron platformën e edukimit në distancë UAL-LMS, nëpërmjet se ciles pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose individualisht, të përcjellin materialet e modulit, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtualisht mbi modulin mësimor.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Ndërsa Programi Fx Education garanton në kohë reale përcjelljen e informacionit të aksesueshëm sipas kategorive në sekretari të mësimore, përgjegjës programi, titullari, staf akademik dhe studentë. Faqja zyrtare e UAL është aktive në dy, gjuhë shqip dhe anglisht, dhe siguron informacion në lidhje me mesimdhënie dhe mbarevajtjen e procesit studimor në këto program studimi.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<i>(Manual i përdorimit të platformës Fx Education)</i>  <i>(Nderfaqe të platformës UAL- LMS.)</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Në RVB citohet se, që në momentin e planifikimit të celjes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL. Cdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UAL. Institucioni kryen çdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Cdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci kontabël);</li> <li>• Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);</li> <li>• Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare;</li> <li>• Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto</li> </ul> <p>Nga raportet financiare të UAL dëshmohet se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p><i>(Strategjia e zhvillimit.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1


Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
------------------------	-------------------------


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni garanton nëpërmjet statutit të Universitetit “Aldent” dhe Rregulloreve të institucionit, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prej tyre vijon zbatimi i ligjit në Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e Programit. Rregullorja e programit përcakton me ligj procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriteret e percaktuara nga MASR për pranimin në ciklin e parë të studimit respektuar renditjen sipas pikëzimit. Sekretaria mësimore mban regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretaria firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, përkatsisht dosjeve të studenteve, GVJ evidentoi që ato ishin të plota dhe konform rregulloreve në fuqi. Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Para çdo fillim viti akademik, në afatet e percaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Në afatet e percaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim.</p> <p><i>(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p><i>(Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Takimi me dekanin, studentët)</i> <i>(RVB)</i> <i>(Vendim Senati mbi Kriteret e pranimit në programin e studimit)</i></p>




përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional.  Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UA dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i Fakultetit. Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulën, ditën e parë të mësimin.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët mbi procedurën e diplomimit, duke lënë kohë për zgjedhjen e fushës dhe në fillim të vitit të dytë, duke u këshilluar me pedagogët, studentët plotësojnë formularin përkatës.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Cdo fillim viti, studentëve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjigjësit të programit. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<i>(Rregullore e programit të studimit.)</i> <i>(Syllabuset)</i> <i>(Formati i diplomes, Suplementi i diplomës)</i> <i>(RVB)</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi			
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga Përgjegjësi i programit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si dhe tabelat informuese në auditoret e leksioneve. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.  Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentë e të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. Studentët informohen dhe përditësohen me organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orareve mësimore, orareve të praktikave etj. Referuar RVB, kjo zyrë edhe e trajnon edhe e mbështet studentin në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.				
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është i plotë në platformën UAL-LMS dhe Fx Education, i cili njihet mirë nga studentët dhe përdoret në çdo kohë e lehtësisht prej tyre pavarësisht nga distanca. Nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit Aldent, studentët mund të përdorin edhe rubrikën “portal i studentit”, në cdo kohë dhe nga cdo pajisje elektronike të lidhur me internet			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	(Manual perdorimi Fx) (Nderfaqe te platformes UAL- LMS) (Tabelat RVB Ba ne TIR)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikat vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi.  Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet akademike ishte:  Për vitin akademik 2018 – 2019 28 studentë; Për vitin akademik 2019– 2020 46 studentë; Për vitin akademik 2020– 2021 45 studentë;  <b>Totali për një cikël studimi 119 studentë;</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Universiteti, disponon gjithashtu, dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ngrirjen e studimeve, largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Informacioni ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore, nëpërmjet Fx Education.  Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.	Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mësimore, tutori akademik) dhe mund të hyjnë pa të drejtë manipulimi, një kategori e caktuar personash të autorizuar.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë.  (Manual perdorimi Fx) (Analiza vjetore e institucionit)
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	

	(Tabelat RVB Ba ne TIR. Tabela nr.19) (Vizitë në sekretarinë mësimore)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Statuti rregullorja e UA, parashikojnë përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".  Studentët organizohen në Senatin Studentor, me një senator për cdo grup mësimor, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor. Institucioni reagon me fleksibilitet dhe procedura jo burokratike, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e studentëve punojnë si infermierë ose kryejnë praktikën e detyrueshme për marrjen e anëtarësimit në Urdhërin e Infermierit. Në këtë rast, institucioni konsideron si praktikë klinike aplikimin e profesionit në shërbimin aktual duke e vërtetuar me dokument të lëshuar nga drejtuesi i institucionit përkatës ose shefi i shërbimit. Përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohej me pjesëmarrjen e tyre në komisione, si: komisioni i kurrikulave, NJSBC, komisioni i kërkimit shkencor.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentat rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit, të komentojnë rezultatin dhe të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.  Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	(Rregullore e Senatit studentor) (Statuti i UAL) (Rregullore e Universitetit ALDENT) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.				
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi informacione më të detajuara lidhur me procedurat dhe njësitë për informimin e studentëve dhe shërbimet për to në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të Universiteteve. Në përgjigje të këtij interesimi Përgjegjësi i Departamentit na informoi hollësisht lidhur me kërkesën tonë. Sipas tij informacionet bazë studentët i merrnin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi që në Universitetin Aldent është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike. Studenti informohet vazhdimisht dhe shërbehet sa herë ai e kërkon shërbimin. Në Universitetin Aldent Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët në mënyrë periodike që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Duke ndërmjetësuar interesimin dhe potencialet e të dyja palëve ajo realizon si kërkesat e tregut të punës ashtu edhe punësimin e studentëve të diplomuar.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Kjo zyrë gjithashtu mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të PS Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion studentëve nëpërmjet faqes zyrtare në interne.</p> <p><i>Rregullore e tutorialit</i> <i>Sudim tregu Ba ne TIR</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar RVB, si edhe takimit me përfaqësues të NjSBC, u cilësua se: Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionut të Arsimit të Lartë. Në zbatim të këtij neni, Senati Akademik i UAL ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të</p>	


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili funksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë;</li> <li>• Bashkërendon procesin ndërmjet njësive në nivel institucional;</li> <li>• Interpretin detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë;</li> <li>• Monitoron procesin, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton problem;</li> <li>• Administron dokumentacione, organizon dhe përfaqëson vizita të vlerësimit të jashtëm;</li> <li>• Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele;</li> <li>• Lehtëson krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies;</li> <li>• Siguron informacion për cilësinë e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit;</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në përbërje të NjSBC përfshihen përfaqësues të Fakulteteve, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i Unionit Studentor. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë NjSBC dhe përgjegjësit e programeve, përgatisin raporte periodike të vetëvlerësimit, të cilat i propozohen Senatit Akademik për miratim. NjSBC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standartet, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standarteve të paracaktuara për krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p> <p><i>Strategjia e zhvillimit UAL 2016-2021</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit ALDENT</i></p> <p><i>Rregullore e NjSBC</i></p> <p><i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela 20</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të NjSBC</i></p> <p><i>Raporti i pyetësorit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<b>Standardi VI.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit dhe përmirësimi i tij kryhet nga njësia ofruese e programit të studimit dhe NjsBC nëpërmjet ristrukturimit të programit të studimit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore; standarteve dhe kritereve të studimeve; cilësisë dhe numrit të nevojshëm të stafit akademik; politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë bashkëkohore; infrastukturës mësimore, monitorimit dhe vlerësimi të brendshëm dhe akreditimit;			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	UAL përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike. Në rastin e akreditimit hartohet nga GVB në nivel programi, miratuar nga Senati Akademik.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UAL përdor metodologji vlerësimi, instrumentat matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbajtjen e programit të studimit si Treguesit e performancës akademike apo pyetësorin e studentëve. Strukturat e ndryshme të SBC, Dekani i Fakultetit, përfaqësuesi i NjsBC në programin e studimit mbikëqyrin zbatimin e programit mësimor. Raporti i hartuar nga NjsBC i kalon Rektorit, i cili e shtron në Senatin Akademik për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e performancës dhe cilësisë. NjsBC cdo fun dvti akademik publikon Raportin Vjetor, në përmbajtjen e të cilit përshkruhet edhe plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Pyetësi i studenteve</i> <i>Raporti i pyetësorit</i> <i>Formulari i performances akademike</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi VI.3**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe takimeve në institucion, NjSBC, mbi bazën e të dhënave të mbledhura, harton Raportin Vjetor të saj, i cili vihet në dispozicion të rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Institucioni kryhen një analizë gjithëpërfshirëse vjetore dhe paraqet Raportin vjetor të Universitetit. Ky raport dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR.</p> <p>Universiteti Aldent duke qënë i profilizuar në ofrimin e programeve të studimit në fushën mjeksore, metodat dhe instrumentat e përdorur janë specifikë dhe në përputhje me fushën akademike. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumentat e përdorur i përshtaten fushës akademike të programit të studimit dhe përdoren periodikisht nga IAL.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për të realizuar vlerësimin e programit të studimit përdoren disa <u>metoda të drejtëpërdrejta</u> si vlerësimi i cilësisë së provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve. GVJ konstatoi që IAL përdor metoda të drejtëpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korrigjimit të provime, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. Nuk ka pasur raste të vlerësimit paralel të provimeve apo detyrave të kursit apo vëzhgime në auditor, si edhe testime të standartizuara. Por, stafi bazohet në pyetjet e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, në hartimin e tezave të provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>IAL përdor disa <u>instrumenta të tërthortë</u> për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit si pyetësorin për lëndën; pyetësori për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësori për kënaqësinë e studentëve me shërbimet, pyetësori me alumni. Kështu vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, përpara fillimit të provimeve. Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit. Rezultatet e të gjitha anketave përpunohen dhe i shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së programit. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që këto instrumenta përdoren periodikisht dhe i kanë shërbyer përmirësimit të programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor</p>	



<p>metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p><i>Analiza vjetore UAL</i> <i>Vizitë në Sekretarinë Mësimore</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

#### Standardi VI.4


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të NJSBC ka aktorë që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, nga një anëtar për cdo fakultet, një ekspert të jashtëm si dhe një përfaqësues studentësh, me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe vizitës në institucion, GVJ konfirmon që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e Fakultetit, Përgjegjësin e Departamentit, përfaqësues të stafit akademik të brendshëm dhe të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>jashtëm, me grupin e vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Duke qënë në unison, për një proces sa më korrekt dhe me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e veta, institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Cdo grup është i pavarur, i barabartë, ushtron kompetencat në përputhje me autonominë që u siguron legjislacioni. Edhe studentët shprehen pozitivisht dhe gëzojnë të drejtat e tyre, ashtu sic njohin edhe detyrimet akademike, cka u vu re gjatë bashkëbisedimit me përfaqësinë studentore, përgjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar (<i>dok nr. 8 Tabelat RVB Ba ne TIR, tab nr. 20</i>) në NJBSC përfshihet një anëtar/ekspert i jashtëm. Duke ju referuar dokumentacionit, institucioni ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në NJBSC dhe zbatimit të instrumentave të ndryshme të vlerësimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>(<i>Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela 20</i>) (<i>Rregullore e NJSBC</i>) (<i>Aprovimi NJSBC</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njesia e brendshme e sigurimit të Cilësisë është angazhuar fort në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që paraqiten gjatë mesimmedhënies apo auditimet e ndryshme në strukture.</p> <p>Institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njesia e sigurimit te brendshem te cilesise realizon pyetsore te pervitshem ne lidhje me procesin e mesimdhënies. Rezultatet mblidhen perpunohen dhe raportohen ne faqen online te fakultetit. Cdo student mund te aksesojë kete raport.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ne pergjithesi rezultatet kane evidnetuar problematika por ato kane qene jo madhore dhe nuk kane ndikuar ne procesin akademik. <i>(Rregullore e NjsBC)</i> <i>(Formulari performances akademike)</i> <i>(Analiza vjetore UAL)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<i>(Takimi me NJSBC)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi.”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit ofrohet nga një Universitet, i cili ka imazh shumë të mirë lidhur me cilësinë e produkteve të tij studentore;






2. Programi i studimit ofrohet me veçorinë e zhvillimit të mësimin në një Universitet me orientim tërësisht në fushën e mjeksisë;
3. Studentët e këtij programi vlerësojnë shërbimin e ofruar nga të gjitha zyrat në mbështetje të aktivitetit të tyre, duke u kursyer kohën në dobi të procesit mësimor;
4. Personeli akademik i këtij programi, si pjesë përbërse edhe e personelit akademik të Universitetit, ndjehet i vlerësuar dhe i përkushtuar në angazhimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe për të merituar vlerësimin e studentëve;
5. Caktimi i një këshilltari akademik për çdo student edhe në këtë program, rrit sigurinë e studentëve në përballimin me sukses të gjithë problematikës gjatë kohës së studimeve;
6. Strukturë efiçente në organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies vecanërisht asaj online gjatë periudhës së pandemisë;
7. Marrëveshje dhe bashkëpunime në funksion të programit të studimit, vecanërisht me institucione shëndetësore dhe klinika private;

**b. Pika të dobta:**

1. Mungesa në Bibliotekën e Universitetit të disa titujve shqip të literaturës imazherike kryesisht në radioterapi, të paktën të atyre që ekzistojnë aktualisht në mësimdhënien në Shqipëri;
2. Probleme minimale në ndërtimin e programit të studimit në lidhje me selektimin e disa lëndëve në rubrika specifike (A, B, C, D, E) për dhënien e rëndësisë së duhur përgatitjes së studentëve;
3. Staf i akademik efektiv, i angazhuar në këtë program studimi, në disa raste ka mbingarkesë të orëve që mbulojnë;
4. Ka angazhim minimal të stafit akademik efektiv të diplomuar si Teknik Imazherie;

**Rekomandime:**

1. Të pasurohet biblioteka e Universitetit me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit;
2. Të përmirësohet dhe standartizohet në vijimësi kurrikula e PS me synimin që të lehtësohet më tej mobiliteti i studentëve drejt cikleve të studimit master, si dhe të bëhet më praktik e më i dobishëm angazhimi i të diplomuarve të këtij PS në kabinetet shëndetësore. Në këtë kuadër rekomandohet kalimi i lëndës së mamografisë nga lëndë me zgjedhje në lëndë të formimit karakterizues;
3. Institucioni të marrë masa për uljen e ngarkesës mesimore të stafit akademik të këtij program studimi, duke rekrutuar staf të ri akademik me tituj dhe grada;



4. Të përmirësohet angazhimi i stafit akademik me gradë shkencore, dhe rekomandohet angazhimi i stafit ndihmës akademik apo ndihmës lektor me formim akademik si Teknik Imazherie;


### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Radiologic Technician and Radiotherapy"**

#### **a. Strengths and affirmations:**

1. The study program is offered by a University, which has a very good image regarding the quality of its student products;
2. The study program is offered with the peculiarity of teaching development in a University with a completely medical orientation;
3. The students of this study program appreciated that the solutions provided by the offices in support of their activity, inside and outside the Department, led them to the timely and quality fulfillment of their requests and complaints, saving time in benefit of the learning process;
4. The academic staff of this program, also as an integral part of the academic staff of Aident University, feels valued and committed in its commitment to achieve the best possible results and to deserve the appreciation of students;
5. The appointment of an academic advisor for each student in this program, increases the confidence of students in successfully coping with all problems during their studies;
6. Efficient structure in the organization and development of teaching, especially online during the pandemic period;
7. Agreements and collaborations in function of the study program, especially with health institutions and private clinics;

#### **b. Weaknesses:**

1. Lack in the University Library of some Albanian titles on Radiologic technician literature mainly in radiotherapy, at least of those that already exist in Albania;
2. Minimal problems in the construction of the study program in relation to the selection of some subjects in specific sections (A, B, C, D, E) for giving due importance to the preparation of students;





3. Effective academic staff, engaged in this study program, in some cases is covering a high number of teaching hours;
4. Minimal commitment of the effective academic staff graduated as Radiologist Technologist;

**Recommendations:**

1. To enrich the University library with Albanian titles or texts which are related to this study program, as well as updating its existing fund in support of the program;
2. To continuously improve and standardize the SP curriculum with the aim of further facilitating the mobility of students towards master study cycles, as well as to make the engagement of the graduates of this SP in health cabinets more practical and useful. In this context, it is recommended to transfer the subject of mammography from elective courses to courses of characteristic formation;
3. The institution to reduce the teaching load of the effective academic staff in this study program by recruiting new academic staff with titles and grades;
4. To improve the engagement of the academic staff with scientific degrees and it is recommended the engagement of the academic support staff or lecturer assistant with academic training as Radiologist Technologist;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA,				X

<b>VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

